



Pranuar / Dërguar Puniljena / Prodato Received / Delivery	04.04.2023	3	viti год Year
Organ / Njësia Org / Jedinica Org / Unit	SKPMSTHCK	3298/2023	117



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.395/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.395/2023 të datës 22.02.2023 të parashtruar nga ankuesi Rinor Beqiri, nga Vushtrria, kundër vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave KA.Nr.10/2023 të datës 23.01.2023 të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 ,nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.395/2023 e datës 22.02.2023 e parashtruar nga ankuesi Rinor Beqiri.

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.10/23 i datës 23.01.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës më datë 22.08.2022 ka shpallur Konkursin me Nr. Reference: KPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-015 për pozitën Zyrtar Ligjor 2 tri pozita në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë. Në këtë konkurs kanë aplikuar pesëdhjetë e tetë (58) kandidatë në mesin e tyre ka aplikuar edhe ankuesi i cili është përfshirë në fazat e procedurës (listën e shkurtër, testin me shkrim dhe testin me gojë), mirëpo pas publikimit të njoftimit për kandidatët e suksesshëm të datës 07.10.2022 ankuesi nuk ka rezultuar si kandidatë i suksesshëm, ngase sipas formularit të përmbledhjes së vlerësimeve individuale ankuesi është vlerësuar me gjithsej 64.4 pikë.

Ankuesi kundër njoftimin për kandidatët e suksesshëm, më datë 02.11.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Për shkak që një kandidat tjetër në këtë procedurë ka shprehur pretendimin se në këtë procedurë njëri nga kandidatët është emëruar në bazë të lidhjeve familjare sepse i njëjti ka të punësuar në Prokurorin Themelore në Mitrovicë një të afërm të ngushtë. Ndërsa lidhur me këtë pretendim institucioni i është drejtuar Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit e cila përmes emailit të datës 18.01.2023 ka sqaruar se *“Pra, edhe në procese të punësimit, sidomos në institucione ku shtrirja e tyre është pothuajse në gjithë vendin, dhe mundësia për me qenë një apo më shumë persona që në një far mënyre kanë lidhje familjare mes veti, nuk është se Ligji për Parandalimin e konfliktit të interesit e ndalon apriori këtë punësim. Por, e ndalon pjesëmarrjen në çfarëdo vendimmarrje të personave të afërm në lidhje me procesin e punësimit të tyre. Pra, personat që kanë lidhje familjare eventuale me kandidatët që konkurrojnë në punësim, nuk duhen të jenë pjesë e komisioneve vlerësuese, selektuese apo çfarëdo qofshin ato që lidhen me personat e tyre të afërm. Ndërsa e drejta e tyre për konkurrim për punë është e drejtë e garantuar e secilit që i plotëson kushtet e kërkuara me konkurs, përderisa nuk ka ndonjë ndalesë eksplicite në konkurs për ata që kanë dikën të punësuar paraprakisht në atë institucion”*.

Pas këtij opinioni Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me datë 23.01.2023 ka nxjerr Vendim me numër KA.nr.10/23 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit duke i lënë në fuqi njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve.

Ankuesi, kundër Vendimit KA.nr.10/23 të datës 23.01.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 22.02.2023 përmes postës ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila më datë 22.02.2023 është pranuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe është regjistruar nën shenjen A.nr.395/2023 me numër protokollit 1976/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 01.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 10.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër A.nr.395/2023 e datës 22.02.2023 me numër protokollit 1976/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave KA.Nr.10/2023 të datës 23.01.2023 i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Kopja e letërnjoftimit; Pliko postare e datës 21.02.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 10.03.2023 me numër protokollit 2564/2023 bashkë me shkresat e lëndës; Deklaratë për moskëzimit të konfliktit të interesit të datës 19.03.2022; kopja e konkursit e datës 22.08.2022; Ankesa e datës 02.11.2022 me

nr.1831 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës; E-mail i datës 24.01 2023-pranimi i vendimit të KZKA-së; Vendimi i datës 06.09.2022 me nr.409/2022 për themelimin e komisionit përzgjedhës për shërbimin civil; Deklaratë për mosekzekutim të konfliktit të interesit e datës 09.09.2022; Deklaratë për mosekzekutim të konfliktit të interesit e datës 09.09.2022; Deklaratë për mosekzekutim të konfliktit të interesit e datës 09.09.2022; Deklaratë për mosekzekutim të konfliktit të interesit e datës 09.09.2022; Regjistri i aplikacioneve të pranura për pozitën Zyrtar ligjor 2 në Prokurorin Themelore Mitrovicë, tri(3)pozita; Lista e aplikantve që kanë hyrë në listën ngushtë e datës 12.09.2022; Njoftim për përzgjedhjen përfundimtare e datës 07.10.2022; Formulari përmbledhës i vlerësimeve individuale i datës 26.09.2022; Njoftimet e datës 16.09.2022 për pjesëmarrje në testin me shkrim; tabela e aplikantëve dhe nr. e telefonit; Njoftim për pjesëmarrje në intervistën me gojë e datës 23.09.2022 ; Raporti për përgatitjen e listës së shkurtër i datës 12.09.2022; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 27.09.2022; Rekomandim për emërim i datës 03.10.2022; Njoftim i datës 23.09.2022; Kopja e testit me shkrim e datës 19.09.2022 I.E; Deklaratë për mosekzistim i të konfliktit të interesit i datës 19.09.2022; Testi me shkrim i datës 19.09.2022 për G.I; Deklaratë për mosekzistim i të konfliktit të interesit i datës 19.09.2022; Testi me shkrim i datës 19.09.2022 për A.S; Testi me shkrim i datës 19.09.2022 për R.B; Formulari i testit me shkrim; Njoftim i datës 25.11.2022; Dëshmi për dorëzimin e aplikacionit; Aplikacioni për punësim i datës 26.08.2022; Diploma e datës 31.08.2020 me nr.69 e lëshuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Mitrovicës; Çertifikatë për kryerjen e stazhit të Praktikës në baza vullnetare pa pagesë e datës 23.11.2021 me nr.15; Kontratë me nr.15/2020 për punë praktike vullnetare në Prokuroritë e shtetit e lidhur me datë 16.11.2020; Letër rekomandimi e datës 23.11.2021; Rekomandim i datës 19.11.2021; Çertifikatë për përfundimin e trajnimit të kodit të etikës për sjelljen profesionale të prokurorëve; Çertifikatë e vitit 2020; Mirënjohje e datës 30.05.2019; Çertifikatë e datës 23.05.2019; Çertifikatë e datës 23.08.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë; Aplikacioni për punësim i datës 19.08.2022; Diploma universitare e datës 27.08.2020 me nr.59 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini"; Vërtetim i datës 27.09.2021; Kontratë për kryerjen e punës praktike profesionale e datës 19.11.2020; Vërtetim i datës 21.04.2022 i lëshuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës; Vendim i datës 11.10.2021 me nr.1145-1/2021 i lëshuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës; Kontratë mbi angazhimin e praktikantit në zyrën e avokatisë; Certifikatë e datës 08.08.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë; Kopja e letërnjoftimit për S.A; Dëshmi për dorëzimin e aplikacionit e datës 26.08.2022; Aplikacioni i datës 26.08.2022; Certifikatë për kryerjen e praktikës vullnetare e datës 17.06.2020 e lëshuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës; Referencë e datës 31.05.2021 e lëshuar nga Prokuroria Themelore në Pejë; Referencë e datës 31.05.2021 A-nr-64/2021; Çertifikatë e datës 12.08.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë ; Kopja e letërnjoftimit për I.E; Diploma e datës 11.07.2018 nr.1080/18 e lëshuar nga kolegji AAB; Dëshmi për dorëzimin e aplikacionit e datës 06.09.2022; Aplikacioni për punësim i datës 05.09.2022; Kontratë pune për kohë të caktuar e datës 27.12.2021; Kontratë për kohë të caktuar duke filluar prej datës 01.01.2022 deri më 30.06.2022; Kontratë për kohë të caktuar duke filluar prej datës 01.01.2022 deri më 30.06.2022 e nënshkruar 27.12.2021; Kontratë për kohë të caktuar duke filluar prej datës 01.11.2020 deri më 31.12.2020 e nënshkruar 27.12.2021; Kontratë pune zyrtar i Monitorimit i datës 01.07.2022; Certifikatë e datës 12.03.2020 e lëshuar nga Gjykata Themelore e Mitrovicës; Diplomë e datës 06.11.2018 me nr.18 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini"; Vërtetim i marrëdhënies së punës i datës 02.09.2022; Pasqyra e Llogarisë së trustit prej datës 11.06.2019-31.08.2022;

Certifikatë e datës 31.08.2022 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë; letër reference e datës 0-1.09.2022; dhe letër reference e datës 02.08.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shqyrtimin e hollësishëm të çdo prove konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *Sepse*:

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Konkursin me Nr. Reference: KPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ-015 për pozitën *Zyrtar Ligjor 2 tri pozita* në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, kriteret kanë qenë: *"Diplomë Universitare në Fakultetin Juridik, dhe Një (1) vit përvojë pune profesionale"*.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.nr.10/23 të datës 23.01.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, pretendon se gjatë këtij konkursi ka pasur shkelje procedurale sepse nuk janë publikuar pikët e testit me shkrim; mendimi i kërkuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit është një fakt që në kwtw procedurë tw kwtij konkursi janw krijuar rrethana dhe dyshime të bazuara që ky konkurs nuk ka qenë në rregull; nuk më janë numëruar në mënyrë të drejtë përgjigjet e testit me shkrim si në Ese po ashtu edhe përgjigjet e shkurtra; përvoja ime ka qenë adekuate për këtë pozitë; Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë pretendimet e mija ankimore.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se ka pasur shkelje procedurale sepse nuk janë publikuar pikët e testit me shkrim, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave të lëndës, konstaton se procedura e testimit me shkrim është zhvilluar në pajtim me rregullativën ligjore në fuqi respektivisht nenin 32, 33, 34, 35 dhe 36 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ndërsa sa i përket publikimit të rezultateve të testit me shkrim, Kolegji i Këshillit, vlerëson se ankuesi nuk është dëmtuar në aspak në këtë fazë, ngase kjo procedurë ka qenë e njëjtë për të gjithë kandidatët, rrjedhimisht me vetë faktin që ankuesi është përfshirë në intervistë me gojë nënkupton që ka arritur pikët e mjaftueshme në testimin me shkrim dhe i njëjti është njoftuar për fazën e intervistës me gojë komfor procedurave ligjore.

Kolegji i Këshillit, duke e shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se mendimi i kërkuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit është një fakt që në procedurë krijohen rrethana dhe dyshime të bazuara që ky konkurs nuk ka qenë në rregull, konstaton se i njëjti nga kandidatët në këtë procedurë, me rastin e parashtrimit të ankesës në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka pretenduar që njëri nga kandidatët e përzgjedhur e ka një familjar të ngushtë që punon në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë. Me qëllim të vlerësimit të këtij pretendimi Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës ka kërkuar nga Divizioni i Burimeve Njerëzore të konfirmoj pretendimin lidhur me këtë çështje, ndërsa Divizioni i Burimeve Njerëzore i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës më datë 25.11.2022 i është drejtuar Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për këshillim me arsyetim se *Një Zyrtar i përzgjedhur në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë ka lidhje familjare (babai) me zyrtarin e Transportit në po të njëjtën Prokurori*, ndërsa Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit më datë 18.01.2023 ka dhënë përgjigje si: *"E para; Duhet dalluar atë që quhet konflikt interesi prej asaj që quhet nepotizëm. Konflikti i interesit kryekëput lidhet me proceset vendimmarrëse. Pra, ka konflikt interesi atëherë kur për një situatë të tillë"*

ka vendimmarrje nga ndonjë zyrtarë publik i cili ate vendimmarrje e lidh me një interes të vetin ose të personave të tij të afërm. Pra, edhe në procese të punësimit, sidomos në institucione ku shtrirja e tyre është potluajse në gjithë vendin, dhe mundësia për me qenë një apo më shumë persona që në një far mënyre kanë lidhje familjare mes veti, nuk është se Ligji për Parandalimin e konfliktit të interesit e ndalon apriori këtë punësim. Por, e ndalon pjesëmarrjen në çfarëdo vendimmarrje të personave të afërm në lidhje me procesin e punësimit të tyre. Pra, personat që kanë lidhje familjare eventuale me kandidatët që konkurrojnë në punësim, nuk duhen të jenë pjesë e komisioneve vlerësuese, selektuese apo çfarëdo qofshin ato që lidhen me personat e tyre të afërm. Ndërsa e drejta e tyre për konkurrim për punë është e drejtë e garantuara e secilit që i plotëson kushtet e kërkuara me konkurs, përderisa nuk ka ndonjë ndalesë eksplicite në konkurs për ata që kanë dikën të punësuar paraprakisht në atë institucion. E dyta: Nëse ndodhë që të jenë përzgjedhur dikush nga anëtarët e familjes së ndonjë të punësuar më parë në institucionin tuaj, atëherë duhet pasur kujdes që ata persona të mos vinë në konflikt interesi "rast pas rasti". D.m.th. të evitohen situatat kur gjatë ushtrimit të detyrave zyrtare të vij situata kur njeri të vendosë për tjetrin ose edhe ta mbikëqyrë e vlerëson atë. Këto situata, nëse shfaqen, duhet deklaruar nga vet ata (zyrtarët publik) dhe pastaj të shmangen e të evitohen". Andaj Kolegji i Këshillit, konstaton se kërkesa për këshillim e parashtruar në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit nuk nënkupton që kjo procedurë është zhvilluar me shkelje ligjore, sepse kërkesa është bërë me qëllim të shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe sqarimit të kësaj çështje nga organi kompetent siç është Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, si rrjedhojë pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimit ankimor të ankuesit se nuk më janë numëruar në mënyrë të drejtë përgjigjet e testit me shkrim si në Ese po ashtu edhe përgjigje të shkurtra, Kolegji i Këshillit, konstaton se me qëllim të shqyrtimit të këtij perëndimi ankimor kemi kërkuar çelësin e përgjigjeve të testit me shkrim, ndërsa gjatë shqyrtimit të vlerësimit të testit me shkrim dhe duke bërë krahasimin me çelësin e përgjigjeve, Kolegji i Këshillit konstaton se vlerësimi i testit me shkrim për ankuesin është bërë në pajtim me legjislacionin përkatës respektivisht nenin 37 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, kështu që pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit se përvoja ime ka qenë adekuate për këtë pozitë, Kolegji i Këshillit konstaton se: ankuesi posedon Diplomën me Nr. 18 të datës 06.11.2018 të lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", përmes të cilës dëshmohet se më datë 29.06.2018 ka përfunduar studimet themelore në këtë fakultet duke marr titullin Jurist i Diplomuar, ndërsa lidhur me përvojën profesionale të punës posedon Certifikatën e datës 12.03.2020 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë sipas të cilit është vërtetuar se nga data 11.03.2019 deri më datë 11.03.2020 ka përfunduar praktikën gjyqësore në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Vërtetim i marrëdhënies së punës i datës 02.09.2022 të lëshuar nga Kryetarja e Asamblesë të Organizatës ORDA ku vërtetohet se ankuesi z.R.B ka punuar 17 muaj në këtë organizatë në pozitën koordinator i projekteve; , sipas Letër referencës të datës 01.09.2022 të lëshuar nga Gjyqtarja e Departamentit të përgjithshëm në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe kontratë pune prej datës 01.07.2022 deri më datën 31.12.2022 në pozitën Zyrtar i monitorimit në Institutin për Politika Zhvillimore (INDEP), mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi ka plotësuar të gjitha kushtet e konkursit dhe përfshirja e tij në fazat e procedurës është bërë në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, sepse në konkurs është kërkuar vetëm një vit përvojë punë profesionale dhe të gjithë kandidatët që kanë pasur një vit përvojë pune profesional kanë plotësuar këtë kusht, rrjedhimisht meqenëse është kërkuar vetëm një vit përvojë pune profesionale, atëherë Kolegji i Këshillit konstaton se nëse kandidati ka më shumë se një vit përvojë punë kjo nuk

nënkupton që në këtë pikë duhet të vlerësohet me pikë më shumë, kështu që plotësimi i kushteve të konkursit ndërlidhur me përvojën e punës nuk ka qenë kontestuese as nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës por as nga ky kolegji.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të dosjeve të kandidatëve të përzgjedhur, konstaton se kandidati i suksesshëm I.E, posedon Diplomën me Nr.1080/18 të datës 11.07.2018 të lëshuar nga Kolegji AAB, përmes të cilës dëshmohet se më datë 29.06.2018 ka përfunduar studimet themelore në këtë kolegji duke marr titullin Bachelor i Drejtësisë, ndërsa lidhur me përvojën profesionale të punës posedon Certifikatën SKPK/DBNJ/Nr.03 të datës 17.06.2020 të lëshuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës sipas të cilës është vërtetuar se nga data 19.03.2019 deri më datë 18.03.2020 ka përfunduar praktiken në Prokurorinë Themelore në Pejë, kandidati i përzgjedhur A.S ankuesi posedon Diplomën me Nr. 59 të datës 27.08.2020 nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", përmes të cilës dëshmohet se më datë 27.07.2020 ka përfunduar studimet themelore në këtë fakultet duke marr titullin Jurist i Diplomuar ndërsa lidhur me përvojën profesionale të punës posedon Vërtetimin Nr.479/2022 të datës 21.04.2022 të lëshuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës sipas të cilës është vërtetuar se nga data 11.10.2021 deri tani ka vijuar stazhin e praktikantit në zyrën e avokatit Fitim Vokshi, kandidati i përzgjedhur G.I, posedon Diplomën me Nr. 69 të datës 31.08.2020 nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", përmes të cilës dëshmohet se më datë 27.07.2020 ka përfunduar studimet themelore në këtë fakultet duke marr titullin Jurist i Diplomuar, ndërsa lidhur me përvojën profesionale të punës posedon Certifikatën SKPK/DBNJ/Nr.15 të datës 23.11.2021 të lëshuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës përmes të cilit vërtetohet se ka përfunduar stazhin e praktikës nga data 18.11.2020 deri më datë 17.11.2021 në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.

Andaj, mbi bazën e kësaj gjendje faktike Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës në mënyrë të drejtë ka vlerësuar aplikacionet e ankuesit dhe kandidatës së përzgjedhur, duke vepruar në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: 1.1arsimimi dhe kualifikimi profesional, përvoja e punës, shkathtësia dhe aftësitë dhe elementet e tjera të meritë.* Mirëpo, Kolegji në bazë të formularit përmbledhjes të vlerësimeve individuale kandidatja e përzgjedhur I.E, është vlerësuar me gjithsej 78.7 pikë, kandidati A.S është vlerësuar me gjithsej 83/7 pikë, kandidati G.I është vlerësuar me gjithsej 86.5 pikë, ndërsa ankuesi është vlerësuar me 64.4 pikë, kështu që Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku parashihet se: *Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë*".

Nisur nga konstatimet si me sipër, Kolegji vlerëson se procedura e rekrutimit për pozitën *Zyrtar Ligjor 2 tri pozita* në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafi 9 dhe nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës, dhe si rrjedhojë Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së*

Vendimit me numër KA.Nr.10/23 i datës 23.01.2023 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil si dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave sepse ka shqyrtuar pretendimet e ankuesit, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nënin 16 paragrafi 3, nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nënit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.395/2023, datë 04.04.2023

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Arben Mehmeti
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, Rinor Beqiri;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatën e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

